



**RAPORT
MENAXHIMI I MBETURINAVE
KOMUNALE NË KOSOVË**

2023-2024

Prishtinë, 2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure



AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS
KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE
KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY

RAPORT

MENAXHIMI I MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË

2023 - 2024

Prishtinë, 2025



PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	1
LISTA E TABELAVE, FIGURAVE DHE HARTAVE	2
1. HYRJE	3
1.1. Qëllimi i raportit	3
1.2. Fushëveprimi i raportit	5
1.3. Metodologjia e mbledhjes së të dhënave	5
2. KORNIZA LIGJORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË	6
3. MENAXHIMI I MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË	7
3.1. Gjendja aktuale	7
3.2. Gjenerimi i mbeturinave komunale	9
3.3. Deponimi i mbeturinave komunale	13
3.4. Mbulimi më shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale	16
3.5. Faturimi dhe arkëtimi	21
3.6. Deponitë ilegale	25
3.7. Ndarja e mbeturinave në burim – Riciklimi	29
3.8. Mbeturinat Spitalore	31
3.9. Importi dhe eksporti i thasëve dhe qeseve të plastikës si dhe i mbetjeve	33
3.10. Pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe planifikuese për menaxhim të mbeturinave	37
3.11. Menaxhimi i mbeturinave dhe ekonomia rrethore (qarkore).....	40
GJETJET E RAPORTIT	42
REKOMANDIMET	43
REFERENCAT	45
SHTOJCAT	47

**SHKURTESAT**

MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
BE	Bashkimi European
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
JICA	Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
UA	Udhëzimet Administrative
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
MK	Mbeturinat Komunale
MV	Mbeturinat e vëllimshme
N & D	Ndërtimi dhe demolimi
Mko	Mbeturinat komerciale
LM	Ligji për Mbeturina
PKMM	Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave
PAMKOS	Shoqata e kompanive rajonale të menaxhimit të mbeturinave
PMM	Plani për menaxhimin e mbeturinave
RrKMB	Rregullorja komunale për menaxhimin e mbeturinave
DR	Deponi rajonale
KRM	Kompani rajonale e mbeturinave
KP	Kompani private
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
SMIM	Strategjia për Menaxhimin e Mbeturinave
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
MM	Menaxhimi i mbeturinave

**Lista e tabelave, figurave dhe hartave**

Tabela 1.	Sasia e MK të gjeneruara dhe të grumbulluara , (2023 & 2024)
Tabela 2.	Sasia e MK të deponuara/shprehur në ton
Tabela 3.	Mbulimi me shërbim të mbledhjes së MK, (2023 & 2024)
Tabela 4.	Faturimi dhe arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2023 & 2024)
Tabela 5.	Shkalla (%) e arkëtimit për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2023 & 2024)
Tabela 6.	Numri i deponive ilegale ndër vite sipas rajoneve
Tabela 7.	Deponitë ilegale sipas kompozicionit
Tabela 8.	Mbeturinat e trajtuara (ton) sipas llojit për vitin 2023, (ASK)
Tabela 9.	Sasia e mbeturinave spitalore të sterilizuara në 8 qendrat spitalore rajonale
Tablea 10.	Prodhimi i qeseve plastike nga disa kompani vendore 2024
Tabela 11.	Pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe planifikuese për menaxhim të MK, (2023 & 2024)
Figura 1.	Gjenerimi i MK sipas rajoneve dhe në nivel vendi shprehur në kg/banor/vit, (2023 & 2024)
Figura 2.	Deponitë Sanitare të Mbeturinave Komunale
Figura 3.	Trendi i deponimit të Mbeturinave Komunale 2018 - 2024
Figura 4.	Mbulimi me shërbim të mbeturinave komunale për ekonomitë familjare sipas rajoneve, (2023 & 2024)
Figura 5.	Shkalla e mbulimit me shërbim të mbeturinave komunale nga ekonomitë familjare, (2023 & 2024)
Figura 6.	Shkalla e arkëtimit të mbeturinave komunale, sipas rajoneve dhe në nivel vendi, (2023 & 2024)
Figura 7.	Arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të mbeturinave sipas komunave, (2023 & 2024)
Figura 8.	Numri i deponive ilegale sipas rajoneve dhe në nivel vendi
Figura 9.	Numri i deponive ilegale sipas madhësisë në % në nivelin rajonal
Figura 10.	Trendi dhe sasia e mbeturinave spitalore të sterilizuara në 8 qendrat spitalore rajonale
Figura 11.	Sasia e thasëve dhe qeseve plastike të importuara 2018 - 2024
Figura 12.	Sasia e thasëve dhe qesve plastikë të eksportuara 2018 - 2024
Figura 13.	Niveli në (%) i plotësimit të proceseve të kërkuara në nivel vendi, (2023 & 2024)
Harta 1.	Gjenerimi i mbeturinave komunale shprehur në kg/banor/vit (2023 & 2024)
Harta 2.	Shtirja hapësinore e deponive sanitare dhe sasia e mbeturinave komunale të deponuar 2023 & 2024)
Harta 3.	Shkalla e mbulimit me shërbim të mbeturinave sipas komunave, (2023 & 2024)
Harta 4.	Shkalla e arkëtimit për shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale, (2023 & 2024)
Harta 5.	Deponitë ilegale sipas komunave, (2023 & 2024).

1. HYRJE

1.1. Qëllimi i raportit

Në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, specifikisht Neni 60, Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës (AMMK) ka përgjegjësi kyçe dhe të detajuar në fushën e monitorimit, vlerësimit dhe raportimit mjedisor në nivel kombëtar.

Në përputhje të plotë me Ligjin nr. 04/L-060 për Mbeturina dhe ndryshimet e mëvonshme të Ligjit nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturina, Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit e Kosovës (AMMK) ka përgjegjësi për përgatitjen dhe publikimin e raportit mbi Gjendjen e Mbeturinave në Kosovë, i cili duhet të pasqyrojë në mënyrë gjithëpërfshirëse gjendjen aktuale, sfidat, dhe synimet për përmirësimin e gjendjes mjedisore, duke siguruar një bazë të fortë informimi për vendimmarrësit dhe publikun.

Këto dispozita ligjore theksojnë rëndësinë e rolit të AMMK-së si institucion kryesor në përgjegjësinë për financimin dhe koordinimin e monitorimit sistematik të mjedisit, si dhe për krijimin e bazës së të dhënave të besueshme dhe analizave që ndihmojnë në drejtimin e politikave publike dhe në arritjen e objektivave të qëndrueshmërisë mjedisore në Republikën e Kosovës.

AMMK ka përgatitur raportin mbi gjendjen dhe menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë për vitin 2023-2024. Nëpërmjet këtij raporti pasqyrohet një bazë e të dhënave gjithëpërfshirëse mbi menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë. Raporti pasqyronë statusin aktual të menaxhimit të mbeturinave, sfidat kryesore, si dhe masat e rekomanduara nga institucione dhe autoritete përgjegjëse për të përmirësuar situatën mjedisore në këtë fushë. Kjo përgjegjësi përfshin mbledhjen, analizimin dhe prezantimin e të dhënave relevante lidhur me menaxhimin e mbeturinave në nivel kombëtar, duke përfshirë aspektet e grumbullimit, gjenerimit, trajtimit, riciklimit dhe asgjësimit të mbeturinave.

Ky raport ka rëndësi të veçantë për monitorimin e zbatimit të politikave dhe legjislacionit mjedisor dhe për ofrimin e informacionit të besueshëm dhe transparent për palët e interesuara, përfshirë institucionet shtetërore, komunitetin shkencor dhe publikun. AMMK ndërmerr këtë rol si pjesë e mandatit të saj ligjor për të siguruar mënyrat më të mira të menaxhimit të mbeturinave dhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së mjedisit në Republikën e Kosovës, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira të qëndrueshmërisë mjedisore.

Një nga objektivat e këtij raporti është që të dhënat dhe të gjeturat e prezantuara në këtë raport të shfrytëzohen nga politik bërësit qoftë nga niveli qendror ashtu edhe nga niveli lokal, me qëllim që politikatat e menaxhimit të mbeturinave komunale të planifikohen dhe të orientohen drejt.

Pas miratimit të Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë (2024-2035) dhe Plani i Veprimit (2024-2026); është planifikuar një qasje e re dhe më vizionare me objektiva strategjik, që do të luajnë një rol të rëndësishëm edhe në aspektin e përmirësimit ekonomik dhe standardit jetësorë.

Këto objektiva janë planifikuar për zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve dhe infrastrukturës së menaxhimit të integruar të mbeturinave, rritjen dhe avancimin e sektorit të riciklimit të mbeturinave, rritjen e kontrollit të përgjegjësisë dhe zbatimit, si dhe promovimin e praktikave më të mira të menaxhimit të mbeturinave, sidomos duke i dhënë një përqendrim më të theksuar ekonomisë qarkore.



Ndërkaq në nivelin lokal të qeverisjes, komunat po ashtu kanë intensifikuar përpjekjet e tyre për të përmirësuar gjendjen në këtë segment të qeverisjes, ku menaxhimin e mbeturinave tani e shohin si një nga prioritetet në planifikimet e tyre zhvillimore.

Shumica e komunave kanë bërë rishikimin dhe miratimin e planeve komunale të menaxhimit të mbeturinave, ndarjen e buxheteve specifike për menaxhim të mbeturinave, ndërmarrjen e aktiviteteve direkte në pastrimin e deponive ilegale, aktiviteteve për promovimin e vlerave të mjedisit, pjesëmarrjen aktive në projekte të ndryshme mjedisore, bashkëpunimin me donatorë etj.

Gjithashtu nga viti në vit është vërjetur një përmirësim i dukshëm në ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave për qytetarët dhe klientët tjerë, dhe një gatishmëri më e madhe nga ana e komunave në ndërmarrjen e veprimeve dhe realizimin e projekteve me qëllim të përmirësimit të gjendjes në këtë sektor. Zhvillime pozitive në fushën e menxhimit të mbeturinave presim edhe në vitet në vijim, pasi nga donatorët si BE, GIZ, JICA etj. kanë dhënë sinjale pozitive të vazhdimin të mbështetjes përmes investimeve në fushën e menaxhimit të mbeturinave. Këto investimet do të jenë të natyrës direkte, por edhe përmes ngritjes së kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve, zhvillimin e hulumtimeve dhe aspekteve tjera të mbështetjes teknike.

Megjithatë, investimet në projekte të mëdha kërkojnë analizë gjithëpërfshirëse dhe ato duhet të jenë të bazuara në dokumentet si Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë dhe Plani i Veprimit 2024-2026, por poashtu edhe në qasjen dhe trendet që aktualisht janë duke u zhvilluar në BE.

Theksojmë se në këtë raport pasqyrojmë gjendjen reale me të cilën ballafaqohet Kosova dhe komunat sa i përket menaxhimit të mbeturinave komunale. Në rrethana të caktuara disa komuna qëndrojnë më mirë në këtë drejtim, kurse disa komuna tjera ballafaqohen me vështirësi, sfida dhe mosplanifikime të duhura.

Për të pasqyruar progresin në këtë sektor është përdorur metodologjia e krahasimit të të dhënave me vitet paraprake. Kjo metodologji lejon vlerësimin e zhvillimeve dhe përmirësimeve në menaxhimin e mbeturinave në nivel lokal dhe kombëtar, duke nxjerrë në pah sfidat dhe pikat që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

1.2. Fushëveprimi i raportit

Raporti pasqyron përmbushjen e kërkesave të legjislacionit mjedisor dhe dokumenteve planifikuese të menaxhimit të mbeturinave komunale. Janë prezantuar të dhëna mbi gjendjen e mbeturinave komunale të cilat gjenerohen në nivel vendi, duke përfshirë: mbeturinat nga amvisëritë dhe mbeturinat komerciale (MKO).

Raporti paraqet një pasqyrë aktuale mbi gjendjen e menaxhimit të mbeturinave komunale, përfshirë:

- Zbatimin e legjislacionit;
- Mbulimin me shërbim të mbledhjes dhe transportit të mbeturinave;
- Faturimin dhe arkëtimin;
- Regjistrimin e deponive ilegale (të vogla, të mesme dhe të mëdha);
- Sasinë e mbeturinave komunale të grumbulluar dhe të gjeneruara sipas komunave;
- Sasinë e mbeturinave të deponuara;
- Të dhëna lidhur me nismat e komunave për ndarjen e mbeturinave në burim;
- Menaxhimin e mbeturinave të veçanta (spitalore);
- Ekonomia qarkore.

1.3. Metodologjia e mbledhjes së të dhënave

Raportimi i të dhënave është bërë përmes WebAplikacionit, ku janë raportuar të dhënat për dy vitet 2023-2024. Verifikimi i vërtetësisë së të dhënave të raportuara është bërë përmes shkëmbimit të të dhënave plotësuese dhe dokumenteve tjetra relevante që janë siguruar nga bashkëpunimi me komunat dhe KRM-të, por edhe përmes krahasimit të data bazës së viteve paraprake, që AMMK tashmë e ka të ndërtuar.

Në këtë raport janë prezantuar të dhënat që janë siguruar nga komunat e Kosovës, kompanite rajonale dhe lokale të licencuara që merren me mbledhje dhe transport të mbeturinave komunale (KRM) kompania për menaxhimin e deponive (KMDK) si dhe nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), të cilat kanë raportuar në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) për vitet 2023 dhe 2024. Këto të dhëna përfshijnë informacionet lidhur me menaxhimin e mbeturinave, përmbushjen e kërkesave ligjore, situatën me deponitë ilegale, shkallët e faturimit dhe arkëtimit të shërbimeve, si dhe progresin e proceseve të ndryshme në këtë sektor, duke siguruar një pasqyrë të plotë mbi gjendjen dhe zhvillimin e menaxhimit të mbeturinave në nivel lokal dhe kombëtar.

Raporti është hartuar duke përdorur të dhënat e raportuara nga:

- Komunat, përmes zyrtarëve komunal, përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave;
- Operatorët e mbledhjes dhe transportit të mbeturinave (KRM, Njësitë Komunale, etj.);
- Kompanitë e menaxhimit të deponive (KMDK, KRM etj.);
- Të dhëna nga ASK, si dhe;
- Të dhëna tjera plotësuese gjatë procesit të vlerësimit dhe verifikimit.



2. KORNIZA LIGJORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË

Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë është i rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina, respektivisht me Ligjin Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina.

Qëllimi kryesor i këtij ligji është parandalimi dhe reduktimi në masë të madhe i gjenerimit të mbeturinave, promovimi i ripërdorimit të komponentëve të përdorshëm, si dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm përmes mbrojtjes dhe ruajtjes së resurseve natyrore. Gjithashtu, ligji synon parandalimin e ndikimeve negative të mbeturinave mbi mjedisin dhe shëndetin publik, duke siguruar një deponim përfundimtar të mbeturinave në mënyrë të pranueshme dhe të qëndrueshme nga ana mjedisore.

Gjithashtu, janë të miratuara edhe një mori e udhëzimeve administrative që e kanë bazën në këtë ligj. Udhëzimet administrative që ndërlidhen direkt me rregullimin e menaxhimit të mbeturinave komunale janë:

- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr.08/2017 për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave;
- Udhëzim Administrativ (MMPHI) Nr.03/2024 për Kriteret për Zgjedhjen e Lokacionit të Deponive si dhe Kushtet Teknike sipas Destinimit të Tyre;
- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 04/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2023 për Ambalazhin dhe Mbeturinat e Ambalazhit,
- Udhëzim Administrativ (MMPHI) - Nr. 20/2014 për Menaxhimin e Mbeturinave Biodegraduese;
- Udhëzim Administrativ Nr. 13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave etj.

Planifikimi dhe menaxhimi i mbeturinave është i rregulluar edhe me dokumente strategjike siç janë:

- Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë (2024-2035) dhe Plani i Veprimit (2024-2026);
- Planet komunale për menaxhimin e mbeturinave;
- Rregulloret komunale për menaxhimin e mbeturinave.
- Planet për menaxhimin e mbeturinave nga zotëruesit e mbeturinave;
- Planet për menaxhimin e mbeturinave nga personat e licencuar, etj.



3. MENAXHIMI I MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË

3.1 Gjendja aktuale

AMMK bën monitorim të rregullt në teren me qëllim të vlerësimit të gjendjes së mjedisit dhe gjithashtu mbledh të dhëna nga akterë të ndryshëm si komunat, operatorët e licencuar për menaxhimin e mbeturinave dhe KMDK. Këto të dhëna i përpunon dhe i vlerëson, dhe mbi bazën e tyre bënë vlerësimin e gjendjes në sektorin e menaxhimit të mbeturinave.

Të dhënat e mbledhura nga raportimi në WebAplikacionin e AMMK -së nga komunat dhe operatorët e licencuar janë përpunuar dhe vlerësuar në mënyrë cilësore, duke përfshirë gjithë ciklin e menaxhimit të mbeturinave, nga gjenerimi deri te trajtimi përfundimtar i tyre. Në bazë të rezultateve të fituara, vërehet një përmirësim i treguesve kyç në këtë sektor.

Duke u bazuar në trendin e të dhënave, me disa përjashtime të kufizuara, vlerësohet se ka një avancim të dukshëm të indikatorëve përkatës në menaxhimin e mbeturinave në nivelin e përgjithshëm.

- Grumbullimi total i mbeturinave në nivel vendi ka rënë nga 471,278.00 ton në vitin 2023 në 449,707.93 ton në 2024 (ulje prej 21,570.07 ton) ndërsa gjenerimi i mbeturinave për banor është rritur ndjeshëm në shumicën e komunave nga 240.15 kg/banor/vit në 293.60 kg/banor/vit, – kjo tregon se numri i banorëve të rinj (nga regjistrimi i fundit në vitin 2024) është më i ulët se vlerësimi i mëparshëm.
- Në pothuajse të gjitha komunat është shënuar përmirësim i madh në eliminimin e deponive ilegale, vërehet një rritje e numrit të deponive të vogla, ndërsa deponitë e mëdha dhe të mesme janë zvogëluar në nivelin rajonal të vendit. Kjo tregon progres drejt një menaxhimi më të përqendruar dhe të kontrolluar të mbeturinave për shkak të aksioneve të pastrimit të ndërmarra, shtimit të inspektimeve, shqiptimeve të gjobave për qytetarët dhe operatorët, si dhe vendosjes së tabelave ndërgjegjësuere dhe informuese për parandalimin e hudhjes së mbeturinave.
- Në shkallën e mbulimit, me shërbim të mbledhjes së mbeturinave për ekonomitë familjare në nivel të vendit të dhënat tregojnë një ndryshim të vogël, një ulje prej rreth 2.7% krahasuar me vitin paraprak. Ky ndryshim, megjithëse relativisht i vogël, pasqyron sfidat me të cilat përballen sistemet e menaxhimit të mbeturinave dhe duhet të analizohet në raport me ndryshimet demografike, shpërndarjen e popullsisë dhe faktorët operativë në nivel vendi.
- Treguesit financiarë të faturimit dhe arkëtimit për shërbimet e ekonomive familjare në rajone tregojnë ndryshime të dukshme në krahasim me vitin 2023. Në nivel vendi, faturimi është rritur nga rreth 19 milionë euro në 20.2 milionë euro, ndërsa arkëtimi ka përmirësuar normën nga 16.9 në 18.2 milionë euro. Bazuar në këto të dhëna, trendi i rritjes së shkallës së arkëtimit për ekonomitë familjare ka shënuar një përmirësim për vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 në disa rajone kryesore.
- Niveli i përmbushjes së pajtueshmërisë ligjore për menaxhimin e mbeturinave ka arritur një mesatare prej 65 - 66% të zbatueshmërisë, duke mbetur i njëjtë krahasuar me vitin paraprak.
- Për dallim nga viti 2023, kur sasia totale e mbeturinave të depozituara në deponitë sanitare ishte 493,116.48 ton, në vitin 2024 kjo sasi është ulur në 468,111.50 ton. Kjo përbën një ulje afërsisht



4.9%. Ky trend pozitiv tregon përpjekje dhe rezultate në drejtim të reduktimit të mbeturinave në deponitë sanitare.

Bazuar në monitorimet e rregullta të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), vlerësohet se deponitë sanitare në Kosovë përballen me një sërë problemesh operacionale dhe mjedisore që kërkojnë vëmendje. Gjendja aktuale e këtyre deponive është larg standardeve evropiane për menaxhimin e mbeturinave. Ndër problemet më të rëndësishme janë: mungesa e sistemit të trajtimit të ujërave të zeza, ventilimi i pamjaftueshëm i gazrave, mbulimi jo i përditshëm i mbeturinave, mungesa e sistemit të ndarjes së tyre, zjarret si dhe mungesa e rrethimit dhe shenjave të rrezikshmërisë. Në hapësirat e deponive vërehen gjithashtu prezenca e qenve endacakë, insekteve dhe personave të paautorizuar.

Sa i përket ofrimit të infrastrukturës së komunave për trajtimin e mbeturinave të veçanta, si ato shtazore, mjekësore, të ndërtimit dhe vëllimore, bazuar në raportet e mbledhura dhe analizimin e PKMM-ve, është vlerësuar se komunat hasin në vështërsi në këtë drejtim. Gjithashtu, në lidhje me iniciativat për ndarjen e mbeturinave në burim, komunat nuk kanë shënuar ndonjë progres të rëndësishëm.

Nga niveli qendror ka iniciativa për zbatim e projekteve të parapara me strategji dhe plan të veprimit, siç janë studimet e fizibilitetit për deponitë sanitare, përveç kësaj, është në fazën fillestare zbatimi i sistemit të rikthimit të depozitave për shishet dhe kanaçet, me synimin për të nxitur riciklimin dhe reduktimin e mbeturinave plastike. Sipas të dhënave zyrtare nga Dogana e Kosovës është vërejtur një rënie e importimit dhe eksportit të qeseve dhe thasëve plastike, e cila mund të lidhet drejtpërdrejtë me zbatimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 04/2025 për Ambalazhin dhe Mbeturinat e Ambalazhit. Shumë biznese kanë zbatuar me përpikëri këtë masë parandaluese, ndërsa qytetarët kanë treguar një vetëdije të rritur në përdorimin e qeseve të biodegradueshme. Edhe më tuje Kosova ballafaqohet me mungesën e iniciativave të mirëfillta qoftë në nivel lokal apo edhe në nivel vendi, drejtë menaxhimit të mbeturinave duke ndjekur ekonominë qarkore. Komunat nuk kanë krijuar kushte për ndarjen e mbeturinave në burim, hap ky i cili i paraprinë edhe riciklimit të mbeturinave.

Disa operatorë privat janë duke realizuar aktivitetet në mbledhjen e mbeturinave të klasifikuara, megjithatë ky proces më tepër është duke u mbulur nga sektori jo-formal, duke e bërë të paqartë dhe të vështirë monitorimin. Duhet të rritet bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve me nivelin qendror dhe ndërkomunal, duhet të shtohet bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm në mënyrë që të rriten investimet dhe të realizohen projekte të qëndrueshme në menaxhimin e mbeturinave.

3.2 Gjenerimi i mbeturinave komunale

Pas verifikimit dhe analizimit të të dhënave të mbledhura, janë përgatitur rezultate reprezentative që pasqyrojnë nivelin e gjenerimit të mbeturinave komunale sipas komunave dhe në nivel vendi për vitet 2023 dhe 2024. Megjithatë, duhet theksuar se duke u bazuar në këto të dhëna raportuese, nuk është e mundur të nxirret një pasqyrë e diferencuar për sasinë e mbeturinave të gjeneruara nga zonat rurale dhe urbane gjatë këtyre viteve. Bazuar në të dhënat e siguruar nga raportet e komunave dhe operatorëve, nga sasia totale e mbeturinave të gjeneruara mund të llogaritet një gjenerim mesatar i mbeturinave për banorë në nivel të komunave, rajoneve dhe në nivel vendi.

Pavarësisht se raportimi nga komunat nuk ka qenë i plotë, dhe disa prej tyre nuk kanë dorëzuar të dhëna për periudhën përkatëse raportuese, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) ka kryer një vlerësim të kujdesshëm të të dhënave të pranuar. Ky vlerësim ka për qëllim ofrimin e një pasqyre sa më të qëndrueshme dhe të afërt me realitetin mbi sasinë e mbeturinave komunale të gjeneruara në nivel vendi.

Raporti i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë për vitet 2023 dhe 2024 tregon ndryshime të konsiderueshme në sasinë e mbeturinave të grumbulluara dhe të gjeneruara për banor në disa komuna. Bazuar në të dhënat vërehet se grumbullimi total i mbeturinave ka rënë nga 471,278.00 ton në vitin 2023 në 449,707.93 ton në 2024 (ulje prej 21,570.07 ton).

Duke pasur parasysh numrin e banorëve të shërbyer, është llogaritur norma e gjenerimit të mbeturinave komunale për kokë banori në Kosovë për vitin 2023 që është 240.15 kg/banor/vit apo 0.66 kg/banor/ditë. Për vitin 2024, kjo normë është rritur në 0.80 kg/banor/ditë, përkatësisht 293.60 kg/banor/vit.

Vlen të theksohet se për vitin 2023 vlerësimi i gjenerimit të mbeturinave komunale për kokë banori në ditë dhe në vit, është bërë duke përdorur numrin e popullsisë sipas regjistrimit të vitit 2011 ndërsa për vitin 2024 është përdorur regjistrimi i popullsisë i vitit 2024, i cili reflekton ndryshimet demografike më të fundit dhe pritet të jetë më i saktë.

Kjo rritje e normës së gjenerimit të mbeturinave tregon një tendencë rritjeje të prodhimit të mbeturinave komunale nga banorët, gjë që reflektohet në nevojën për menaxhim dhe trajtim më efektiv dhe të qëndrueshëm të mbeturinave në vend.

Në vlerësimin e sasisë së mbeturinave komunale të gjeneruara për vitin 2023, duhet marrë parasysh se mund të ketë pasur disa pasaktësi të pashmangshme. Kjo për shkak se për këtë vit janë përdorur të dhëna zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011¹.

Në disa komuna, numri i banorëve sipas statistikave zyrtare nuk përputhet me numrin real të banorëve që përfitojnë shërbimin e mbledhjes së mbeturinave. Për më tepër, disa komuna nuk kanë raportuar për vitin 2023, gjë që shton paqartësitë në vlerësimin e përgjithshëm.

Ndërkaq, për vitin 2024 janë përdorur të dhëna nga regjistrimi i fundit i popullsisë, që është zhvilluar gjatë vitit 2024.² Ky regjistrim e ofron një pasqyrë më reale dhe të besueshme të numrit të banorëve dhe ekonomive familjare, duke e përmirësuar ndjeshëm saktësinë e indikatorëve të mbeturinave.

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2011

² Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2024

Nga ana tjetër, edhe pse për vitin 2024 ka mungesa të të dhënave për komuna, përdorimi i këtyre të dhënave të reja përmirëson cilësinë e analizave dhe reflektimin e realitetit të ri demografik.

Prandaj, ndryshimet ndërmjet viteve 2023 dhe 2024 duhet të merren, duke pasur parasysh ndryshimin thelbësor në burimet dhe cilësinë e të dhënave të përdorura.

Në gjithë Kosovën, mesatarja e gjenerimit të mbeturinave ndërmjet viteve 2023-2024, tregon se kemi një rritje prej 53.45 kg/banor/vit. Kjo rritje e konsiderueshme mund të tregon një intensifikim të prodhimit të mbeturinave komunale, i cili mund të vijë si pasojë e ndryshimeve në sjelljet konsumatorë, urbanizimit të vazhdueshëm, si dhe përmirësimeve në sistemet e mbledhjes dhe raportimit të mbeturinave në Kosovë.

Pra, gjenerimi i mbeturinave komunale po rritet në shumë rajone të Kosovës, dhe ky është një tregues i rëndësishëm për menaxhimin më efektiv të mbeturinave dhe nevojën për politika më të mirë të riciklimit dhe trajtimit të mbeturinave.

- Rajoni i Gjilanit dhe Mitrovicës kanë një rritje të qartë të mbeturinave të gjeneruara për banor në vitin 2024 në krahasim me vitet e mëparshme, me 411.31 dhe 364.48 kg/banor/vit.
- Rajoni i Prishtinës gjithashtu ka një rritje në 284.89 kg/banor/vit në vitin 2024 nga 252.13 kg në 2023 ka pasur rritje prej 32.76 kg/banor/vit.
- Rajonet e tjera si Peja, Prizreni, Ferizaj dhe Gjlani kanë pasur edhe ato rritje te madhe.
- Rajoni i Gjakovës ka pasur një rënie prej 19.09 kg/banor/vit, nga 197.91 në 178.82 në vitin 2024.

Në nivel vendi mesatarja është 293.60 kg/banor/vit në 2024, që është rritje nga 240.15 kg/banor/vit në 2023.





Figura 1. Gjenerimi i MK sipas rajoneve dhe në nivel vendi shprehur në kg/banor/vit, (2023 & 2024)

Të dhënat e detajuara lidhur me sasinë e mbeturinave të grumbulluara dhe të gjeneruara janë dhënë në shtojcën 1 dhe 2 të raportit.

**Tabela 1.** Sasia e MK të gjeneruara dhe të grumbulluara 2023 & 2024

Grumbullimi dhe gjenerimi i MK³						
Rajoni	(2023)			(2024)		
	Mbeturinat e përziera komunale të grumbulluara (kg/vit)	Gjenerimi i mbeturinave për kokë banori (kg/vit)	Gjenerimi i mbeturinave për kokë banori (kg/ditë)	Mbeturinat e përziera komunale të grumbulluara (kg/vit)	Gjenerimi i mbeturinave për kokë banori (kg/vit)	Gjenerimi i mbeturinave për kokë banori (kg/ditë)
<i>R. i Prishtinës</i>	160,996,000.00	252.13	0.69	139,818,000.00	284.89	0.78
<i>R. i Mitrovicës</i>	55,200,000.00	273.60	0.75	51,167,930.00	364.48	1.00
<i>R. i Pejës</i>	52,384,000.00	269.97	0.74	47,541,000.00	293.97	0.81
<i>R. i Prizrenit</i>	95,348,000.00	210.05	0.58	93,801,000.00	290.13	0.79
<i>R. i Ferizajit</i>	37,624,000.00	205.30	0.56	49,736,000.00	297.53	0.82
<i>R. i Gjilanit</i>	39,033,000.00	287.39	0.79	41,103,000.00	411.31	1.13
<i>R. i Gjakovës</i>	30,693,000.00	197.91	0.54	26,541,000.00	178.82	0.49
Kosovë	471,278,000.00	240.15	0.66	449,707,930.00	293.60	0.80

³ Gjenerimi bazohet në sasinë e MK të grumbulluara, nuk janë përfshirë në llogaritje mbeturinat që nuk mbledhen dhe ato të vëllimshme.



Harta 1. Gjenerimi i mbeturinave komunale shprehur në kg/banor/vit (2023 & 2024)

3.3 Deponimi i mbeturinave komunale

Nga raportimi në WebAplikacionin online të AMMK-së sasi të mbeturinave të depozituara në 7 deponitë sanitare në Kosovë gjatë vitit 2023 dhe 2024 kanë pasur ndryshime, duke pësuar rritje në disa rajone dhe rënie në disa të tjera.

Gjendja e deponimit të mbeturinave në të shtatë deponitë sanitare kryesore të vendit, duke treguar dinamikën dhe ndikimet e ndryshme rajonale është paraqitur grafikisht në (figurën 2). Në vitin 2024 sasia e mbeturinave të deponuara në total të të gjitha deponive (të menaxhuara nga KMDK-ja dhe KRM-të), është ulur krahasuar me vitin 2023, nga 493,116.48 ton në vitin 2024 në 468,111.50.

Në deponitë që menaxhohen nga KMDK-ja, sasia e mbeturinave të deponuara në vitin 2024 është 362,318.90 ton, që përfaqëson një ulje prej 17,372.60 ton në krahasim me vitin 2023 (379,691.50 ton).

Në deponitë që menaxhohen nga KRM-të, vërehet gjithashtu një ulje e lehtë nga 113,424.98 ton në vitin 2023 në 105,792.60 ton në vitin 2024.

Në nivel rajonal, disa vende kanë raportuar ulje të konsiderueshme të mbeturinave të deponuara, përfshirë Gjilanin dhe Prizrenin, ndërsa disa vende si Prishtina dhe Podujeva kanë shënuar një rritje të vogël. Këto ndryshime mund të tregojnë për një ulje të përgjithshme në sasinë e mbeturinave të deponuara, që mund të lidhet me përmirësime në menaxhim ose me sektorë të tjerë që ndikojnë në menaxhimin e mbeturinave në nivel vendi.

Duhet të ceket se në këtë sasi të mbeturinave nuk është përfshirë sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë në pjesën veriore të Kosovës si: (deponia në Zveçan, Zubin- Potok, Leposaviq) pasi nuk ka të dhëna të raportuara për vitet 2023 -2024.

Tabela 2. Sasia e MK të deponuara/shprehur në ton

Deponitë Sanitare	2020	2021	2022	2023	2024
<i>Prishtinë (Mirash)</i>	152,215.43	181,215.42	182,701.49	191,644.72	193,698.74
<i>Gjilan (Velekincë)</i>	67,075.81	58,651.52	57,548.62	53,343.76	48,746.68
<i>Podujevë (Dumnicë)</i>	16,194.56	17,793.01	17,451.09	17,239.00	18,103.20
<i>Prizren (Landovicë)</i>	105,305.18	118,323.04	128,832.09	117,464.02	101,770.28
Nëntotali në deponitë e menaxhuara nga KMDK:	340,790.98	375,982.99	386,533.29	379,691.50	362,318.90
<i>Mitrovicë (Gërmovë)</i>	47,415.38	49,027.54	52,857.09	54,063.48	42,273.33
<i>Pejë (Sferk)</i>	52,496.00	57,752.00	56,007.40	51,882.50	53,015.27
<i>Dragash (Sharr)</i>	5,630.00	7,193.00	7,490.00	7,479.00	10,504.00
Nëntotali në deponitë e menaxhuara nga KRM-të:	105,541.38	113,972.54	116,354.49	113,424.98	105,792.60
<i>Deponia në Zveçan*</i>	*	*	*	*	*
<i>Zubin-Potokut (Lluçkarekë)*</i>	*	*	*	*	*
<i>Deponia në Leposaviq*</i>	*	*	*	*	*
Gjithsej	446,332.36	489,955.53	502,887.72	493,116.48	468,111.50

*Nuk janë raportuar të dhëna për këto deponi.




Figura 2. Deponitë Sanitare të Mbeturinave Komunale





Figura 3. Trendi i deponimit të Mbeturinave Komunale 2018 - 2024



Harta 2. Shtrirja hapësinore e deponive sanitare dhe sasia e mbeturinave komunale të deponuar 2023 & 2024

3.4. Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale

Shërbimi themelor i mbledhjes dhe transportit të mbeturinave komunale dhe transferimin e tyre në deponitë sanitare për deponim në komuna kryhet nga operatorët publik dhe privat të licencuar. Në tabelën 3, 4 dhe 5 është pasqyruar niveli i mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale sipas rajoneve, respektivisht sipas komunave.

Kurse në hartën 3 është dhënë një pasqyrë e shkallës së mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave sipas komunave. Ndërkaq në formë më të detajuar në shtojcën 3 është paraqitur shkalla e mbulimit me shërbim të mbeturinave për komunat të cilat kanë raportuar të dhëna të menaxhimit të mbeturinave për vitet 2023 dhe 2024.

Në përgjithësi, krahasimi i shkallës së mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave për ekonomi familjare midis viteve 2023 dhe 2024 tregon tendenca ndryshimi pozitive dhe negative në disa komuna. Disa komuna ruajnë mbulim të plotë, disa kanë përkeqësime, ndërsa të tjera kanë përmirësuar shërbimin e mbledhjes së mbeturinave në vitin 2024.

Pas verifikimit të të dhënave, është vlerësuar se këto komuna kanë arritur në shkallën 100% të mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave në të dy vitet (2023 dhe 2024), si (Prishtinë, Fushë-Kosovë, Graçanicë, Mitrovicë, Vushtrri, Pejë, Istog, Klinë, Prizren, Suharekë, Malishevë, Rahovec, Kaçanik, Hani i Elezit, Shtërpçë, Gjakovë, Deçan dhe Junik) shih (figurën 5).

Komuna e Novobërdës ka arritur një përmirësim të ndjeshëm në mbulimin me shërbim të mbledhjes së mbeturinave, ku nga 78.0% në vitin 2023, ka arritur të shënojë mbulim të plotë prej 100% në vitin 2024 shih (figurën 5).

Në disa komuna kemi vërejtur rënie të dukshme të mbulimit si Komuna e Glogocit (Drenasit) nga 82.7% në 74.5%, Komuna e Lipjanit nga 91.4% në 61.1%, Komuna e Obiliqit nga 87.5% në 70.6%, Komuna e Podujevës nga 68.9% në 56.5%, dhe Komuna e Gjilanit nga 85.8% në 65.8% (figura 5).

Komunat të cilat nuk kanë raportuar për të dy vitet janë: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin-Potok, Leposaviq, Klllokot, ndërsa në vitin 2024 nuk kanë raportuar komunat si Mamushë, Ranillugë dhe Partesh (figura 5).

Në vitin 2024, mbulimi me shërbim i mbledhjes së mbeturinave për ekonomitë familjare në nivel vendi ka arritur në shkallën prej 90.93%, duke shënuar një ulje prej rreth 2.7% krahasuar me vitin 2023, kur niveli ishte 93.6% shih (tabela 3).

Të dhënat tregojnë një ndryshim të vogël në shkallën e mbulimit, i cili duhet analizuar në kontekstin e ndryshimeve demografike, shpërndarjes së popullsisë dhe sfidave operative në sistemet e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë.

Të dhënat tregojnë luhatje në disa rajone në shkallën e mbulimit me shërbim gjatë periudhës 2023-2024. Rajonet e Prishtinës, Mitrovicës, Prizrenit, dhe Gjilanit shfaqin një ulje të shkallës së mbulimit, me rënien më të ndjeshme në rajonin e Gjilanit (-11.36%) shih (tabelën 3).

Kjo mund të reflektojë sfida të ndryshme lokale në ofrimin e shërbimeve ose ndryshime në numrin e ekonomive familjare të shërbimeve të mbuluara. Rajoni i Ferizajt ndiqet me një rritje të dukshme (+3.51%), duke treguar përmirësim në ofrimin e shërbimeve.



Rajonet e Pejës dhe Gjakovës mbeten të qëndrueshme me 100% mbulim, duke reflektuar stabilitet në ofrimin e shërbimeve për ekonomi familjare.

Sa i përket indikatorit të mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave, duhet theksuar se deri para vitit 2024 kemi pasur disa pasaktësi të pashmangshme për shkak të përdorimit të të dhënave të vjetruara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), konkretisht nga regjistrimi i popullsisë i vitit 2011. Këto të dhëna ndërkohë nuk e reflektonin më numrin aktual të banorëve dhe ekonomive familjare në komunat e Kosovës, për shkak të ndryshimeve të mëdha demografike dhe trendeve të lëvizjes së popullsisë gjatë këtyre viteve.

Megjithatë, për vitin 2024, janë përdorur të dhëna të fundit të përditësuara nga regjistrimi i ri i popullsisë dhe ekonomive familjare sipas raporteve zyrtare të ASK-së. Ky përditësim ka eliminuar shumë nga pasaktësitë e mëparëshme, duke siguruar një bazë më të besueshme dhe të azhurnuar për numrin e banorëve dhe ekonomive familjare në komunat e Kosovës. Si rezultat, pasqyra e shkallës së mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave në vitin 2024 është më e saktë dhe më reale.

Ky ndryshim thelbësor rrit saktësinë e analizave dhe të dhënave, duke reflektuar më mirë realitetin aktual demografik dhe strukturën e re të popullsisë dhe familjeve në vend.

Sa i përket raportimit të komunave mbi nivelin e ofrimit të mbulimit me shërbimin e mbledhjes së mbeturinave për kategorinë e bizneseve dhe institucioneve, duhet cekur se shumë komuna ende nuk kanë arritur të bëjnë një filtrim të bizneseve aktive dhe atyre pasive dhe në rastin tjetër nuk kanë ofruar të dhëna të llogaritshme sipas formatit të raportimit, çka ka ndikuar në pamundësinë e një vlerësimi adekuat të indikatorit për vitin 2023 dhe 2024.

Për llogaritjen e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave është përdorur përkufizimi i mëposhtëm:

$$SHm = \frac{N_{ef. sh}}{N_{p. ef.}} \times 100\%$$

* SHm Shkalla e mbulimit

* N ef.sh. – Numri i ekonomive familjare të shërbyera/ të faturuara në 2023

* N ef.sh. – Numri i ekonomive familjare të shërbyera/ të faturuara për vitin 2024


* N p.ef. – Numri i përgjithshëm i ekonomive familjare, sipas regjistrimit të popullsisë ASK-2011 për vitin 2023,

* N p.ef. – Numri i përgjithshëm i ekonomive familjare, sipas regjistrimit të popullsisë ASK-2024 për vitin 2024.

Të dhënat e detajuara lidhur me shkallën e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale janë dhënë në shtojcën 3 në raport.

**Tabela 3.** Mbulimi me shërbim të mbledhjes së MK, (2023 & 2024)

RAJONI	Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave		
	Shkalla e mbulimit me shërbim për ekonomi familjare (2023)	Shkalla e mbulimit me shërbim për ekonomi familjare (2024)	Rritja ose zbritja e shkallës së mbulimit për ekonomi familjare 2023 -2024 (pikë %)
R. i Prishtinës	94.50%	90.48%	-4.02%
R. i Mitrovicës	96.20%	95.37%	-0.83%
R. i Pejës	100.00%	100.00%	0.00%
R. i Prizrenit	99.20%	97.41%	-1.79%
R. i Ferizajit	93.50%	97.01%	3.51%
R. i Gjilanit	76.10%	64.74%	-11.36%
R. i Gjakovës	100.00%	100.00%	0.00%
Kosovë	93.60%	90.93%	-2.7%

**Figura 4.** Mbulimi me shërbim të mbeturinave komunale për ekonomitë familjare sipas rajoneve (2023 & 2024)

Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes së MK





Figura 5. Shkalla e mbulimit me shërbim të mbeturinave komunale nga ekonomitë familjare, (2023 & 2024)



Harta 3. Shkalla e mbulimit me shërbim të mbeturinave sipas komunave, (2023 & 2024)

3.5. Faturimi dhe Arkëtimi

Gjatë vitit 2024, komunat si dhe operatorët e licencuar që merren me mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave komunale janë përballur me vështirësi dhe paqëndrueshmëri financiare, e cila ka qenë veçanërisht e theksuar për shkak të rritjes së inflacionit dhe kushteve të vështira ekonomike gjatë këtij viti. Kjo paqëndrueshmëri është dukur edhe më qartë në kryeqytet, ku është regjistruar një proces i dështuar në menaxhimin e mbeturinave.

Përmirësimi i nivelit të arkëtimit nga komunat dhe operatorët, si dhe planifikimi më i mirë i financave dhe zvogëlimi i kostove operative, janë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë pozitivisht në performancën e shërbimit të mbeturinave. Këto masa kontribuojnë në rritjen e cilësisë së shërbimit dhe përmirësimin e gjendjes së mjedisit, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve për qytetarët.

Në përgjithësi, investimet në infrastrukturë dhe menaxhimin financiar efikas mund të jenë çelësi për tejkalimin e vështirësive aktuale dhe për arritjen e qëndrueshmërisë së sektorit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë.

Bazuar në të dhënat e raportimit për vitin 2024, treguesit financiarë të faturimit dhe arkëtimit për shërbimet e ekonomive familjare në rajone tregojnë ndryshime të dukshme në krahasim me vitin 2023.

Në nivel vendi, faturimi është rritur nga rreth 19 milionë euro në 20.2 milionë euro, ndërsa arkëtimi ka përmirësuar normën nga 16.9 në 18.2 milionë euro.

Bazuar në këto të dhëna, trendi i rritjes së shkallës së arkëtimit për ekonomitë familjare ka shënuar një përmirësim për vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 në disa rajone kryesore, megjithatë në disa raste si në rajonin e Prishtinës është vënë re një rënie në shkallën e arkëtimit.

- Rajoni i Prishtinës ka shënuar një rritje në faturim nga 7,536,810 € në 7,978,410 €, por arkëtimi ka pësuar ulje nga 7,175,762 € në 6,674,297 €.
- Rajoni i Mitrovicës ka pasur rritje të arkëtimit nga 850,788 € në 1,088,553 €, ndërsa faturimi është rritur lehtë nga 1,221,382 € në 1,310,421 €.
- Rajoni i Pejës gjithashtu ka shënuar rritje në faturim dhe arkëtim, duke shkuar në mbi 2 milionë euro.

Çdo rënie e nivelit të arkëtimit ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e operatorëve për të ofruar shërbime adekuate të mbledhjes dhe transportit të mbeturinave. Një sfidë e madhe mbetet edhe fakti se operatorët nuk kanë mundur të ndajnë arkëtimin e faturave për vitin përkatës dhe borxhet e vjetra, gjë që vështirëson pasqyrimin real të shkallës së arkëtimit për vitet 2023-2024.

Të dhënat për shkallën e arkëtimit janë llogaritur duke e përdorur formulën në vijim:

$$SHa = \frac{sh.f.l.v}{sh.f.a} \times 100\%$$

*SHa - Shkalla e arkëtimit

*shf.l.v - Shuma e faturave të lëshuara në vit

*shf.a – Shuma e faturave të arkëtuara në vitin përkatës

Të dhënat e detajuara lidhur me shkallën e arkëtimit janë dhënë në shtojcën 4 në raport.

Tabela 4. Faturimi dhe arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2023 & 2024)

RAJONI	Faturimi për shërbim të ekonomive familjare 2023	Arkëtimi për shërbim të ekonomive familjare 2023	Faturimi për shërbim të ekonomive familjare 2024	Arkëtimi për shërbim të ekonomive familjare 2024
R. i Prishtinës	€ 7,536,810.00	€ 7,175,762.00	€ 7,978,410.00	€ 6,674,297.00
R. i Mitrovicës	€ 1,221,382.00	€ 850,788.00	€ 1,310,421.00	€ 1,088,553.00
R. i Pejës	€ 1,967,194.00	€ 1,764,213.00	€ 2,190,966.00	€ 2,055,013.00
R. i Prizrenit	€ 3,233,148.00	€ 2,786,978.00	€ 3,202,800.00	€ 3,162,781.00
R. i Ferizajit	€ 2,043,962.00	€ 1,549,325.00	€ 2,010,867.00	€ 2,056,036.00
R. i Gjilanit	€ 1,655,407.00	€ 1,471,507.00	€ 1,839,173.00	€ 1,718,472.00
R. i Gjakovës	€ 1,361,526.00	€ 1,329,602.00	€ 1,680,861.00	€ 1,534,992.00
KOSOVË	19,019,429.00	16,928,175.00	20,213,498.00	18,290,144.00

Në bazë të të dhënave të shkallës së arkëtimit të tarifave për shërbimin e mbledhjes së mbeturinave për ekonomitë familjare në 7 rajone për vitet 2023 dhe 2024 në nivel vendi, shkalla e arkëtimit është përmirësuar lehtë nga 89.00% në 90.48% (shih tabela 5).

- Në vitin 2023, shkalla më e lartë e arkëtimit është regjistruar në rajonin e Gjakovës me 97.66%, e ndjekur nga rajoni i Prishtinës me 95.21%.
- Në vitin 2024, shkalla më e lartë e arkëtimit është regjistruar në rajonin e Ferizajit, duke tejkaluar 100% (101.34%), rritje vërehet edhe në Prizren Mitrovicë, Pejë, Gjilan dhe Gjakovë.
- Shkalla më e ulët e arkëtimit në vitin 2023 rezulton në rajonin e Mitrovicës me 69.66%, ndërsa gjatë vitit 2024 shkalla më e ulët e arkëtimit është regjistruar në rajonin e Mitrovicës 83.07% dhe Prishtinës me 83.65%.

Tabela 5. Shkalla (%) e arkëtimit për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2023 & 2024)

RAJONI	Shkalla e arkëtimit 2023	Shkalla e arkëtimit 2024
R. i Prishtinës	95.21%	83.65%
R. i Mitrovicës	69.66%	83.07%
R. i Pejës	89.68%	93.79%
R. i Prizrenit	86.20%	98.75%
R. i Ferizajit	75.80%	101.34%
R. i Gjilanit	88.89%	93.44%
R. i Gjakovës	97.66%	91.32%
Kosovë	89.00%	90.40%

Shkalla e arkëtimit për shërbim të mbledhjes së MK




Figura 6. Shkalla e arkëtimit të mbeturinave komunale, sipas rajoneve dhe në nivel vendi, (2023 & 2024)

Shkalla e arkëtimit për ekonomi familjare sipas komunave %





Figura 7. Arkëtimit për shërbim të mbledhjes dhe transportit të mbeturinave sipas komunave, (2023 & 2024)



Harta 4. Shkalla e arkëtimit për shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale, (2023 & 2024)

3.6. Deponitë ilegale

Sipas të dhënave të raportuara në WebAplikacionin e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), vërehet se, pavarësisht përpjekjeve të konsiderueshme për reduktimin e deponive ilegale në Kosovë gjatë periudhës së fundit, problemi mbetet ende i pranishëm, duke kërkuar monitorim të vazhdueshëm dhe zbatim të masave shtesë për menaxhimin dhe eliminimin e tyre. Të dhënat për periudhën 2020–2024 tregojnë luhajtje në numrin e deponive ilegale, çka dëshmon se kjo sfidë mjedisore vazhdon të jetë e pranishme në disa rajone dhe komuna të vendit (shih tabelën 6).

Sipas madhësisë, deponitë janë klasifikuar në tri kategori: të mëdha, të mesme dhe të vogla, duke u vlerësuar vizualisht sipas vëllimit të tyre. Sa i përket kompozicionit të mbeturinave, deponitë ndahen në kategoritë: (a) deponi të mbeturinave komunale; (b) deponi të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënim; (c) deponi të mbeturinave të rrezikshme; (d) deponi të mbeturinave të vëllimshme; dhe (e) deponi të mbeturinave të tjera.

Krahasuar me vitin 2023, ka pasur një rritje në numrin total të deponive ilegale, nga 403 në 458, pra një shtim prej 55 deponish. Kjo rritje është kryesisht për shkak të shtimit të deponive të vogla, ndërsa numri i deponive të mëdha dhe të mesme është ulur.

Në rajonin e Prishtinës, numri i deponive ilegale ka pësuar një ulje nga 277 në vitin 2020 në 116 në vitin 2023, por është rritur përsëri në 154 deponi në vitin 2024. Kjo tregon se megjithëse ka pasur përpjekje për reduktimin e deponive ilegale deri në vitin 2023, në vitin 2024 është vërejtur një rritje e tyre.

Rajoni i Gjilanit ka pasur numrin më të vogël të deponive ilegale në vitin 2023 me vetëm 13, megjithatë ky numër është rritur në 38 deponi në vitin 2024, duke treguar për një shtim të ndjeshëm të deponive ilegale në këtë rajon.

Në nivel vendor, numri i deponive ilegale ka rënë ndjeshëm nga 1189 në vitin 2020, në 403 në vitin 2023, por ka pësuar një rritje në vitin 2024 duke arritur në 458 deponi ilegale.

Të dhënat e detajuara për deponitë ilegale janë dhënë në shtojcën 5 në raport.

Tabela 6. Numri i deponive ilegale ndër vite sipas rajoneve

RAJONI	2020	2021	2022	2023	2024
Rajoni i Prishtinës	277	150	144	116	154
Rajoni i Mitrovicës	101	118	110	45	45
Rajonii i Pejës	156	68	56	46	39
Rajoni i Prizrenit	256	187	187	74	78
Rajoni i Ferizajit	118	99	93	62	60
Rajoni i Gjilanit	242	111	119	13	38
Rajoni i Gjakovës	39	30	37	47	44
Kosovë	1189	763	746	403	458




Figura 8. Numri i deponive ilegale sipas rajoneve dhe në nivel vendi





Figura 9. Numri i deponive ilegale sipas madhësisë në % në nivelin rajonal

**Tabela 7.** Deponitë ilegale sipas kompozicionit

RAJONI	Mbeturina komunale	Mbeturinat të ndërtimit dhe demolimit	Mbeturinat indust. dhe të rrezikshme	Mbeturinat të vëllimshme	Mbeturinat tjera
<i>Rajoni i Prishtinës</i>	27.0%	41.1%	0.0%	0.6%	31.3%
<i>Rajoni i Mitrovicë</i>	46.4%	19.5%	1.2%	1.4%	31.5%
<i>Rajonii Pejë</i>	46.3%	19.3%	0.3%	0.0%	34.0%
<i>Rajoni i Prizrenit</i>	8.2%	33.5%	0.4%	0.0%	57.9%
<i>Rajoni i Ferizajit</i>	27.3%	37.2%	0.0%	1.1%	34.3%
<i>Rajoni i Gjilanit</i>	28.8%	24.3%	0.0%	0.9%	46.1%
<i>Rajoni i Gjakovës</i>	5.0%	27.5%	0.0%	0.0%	67.5%



Harta 5. Deponitë ilegale sipas komunave, (2023 & 2024)

3.7. Ndarja e mbeturinave në burim – Riciklimi

BE-ja po zhvillon politika për mbeturinat që i mban produktet në përdorim për aq kohë sa të jetë e mundur dhe ka vendosur standarde të rrepta se si t'i asgjësojë ato kur nuk mund të përdoren më. Politikat dhe iniciativat gjithashtu përqendrohen në parandalimin e gjenerimit të mbeturinave në radhë të parë, për shembull, duke zvogëluar mbeturinat ushqimore dhe duke i bërë produktet më të lehta për t'u riparuar. Shumë iniciativa për ripërdorim dhe riciklim mund të kontribuojnë në zvogëlimin e humbjes së burimeve natyrore në BE.⁴

Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë është një nga sfidat kryesore si për nivelin qendror ashtu edhe për nivelin lokal të qeverisjes. Kur flasim për menaxhimin e mbeturinave komunale bazuar në legjislacionin në fuqi përgjegjësia bie direkt mbi nivelin lokal. Ky proces përfshin mbledhjen, transportimin dhe trajtimin e integruar të mbeturinave.

Për shkak të kostos së lartë operative për ndërtimin e qendrave ricikluese në vend, ndarja e mbeturinave në burim edhe më tutje mbetet një nga aspektet e menaxhimit të mbeturinave ku komunat ende nuk kanë filluar që të ndërmarrin iniciativa për nisjen e zbatimit të këtij hapi që paraqet çelës drejt fillimit të menaxhimit të integruar të mbeturinave.

Në mungesë të zbatimit të ndarjes së mbeturinave në burim, nuk mund të zhvillohet një sistem i qëndrueshëm i riciklimit të mbeturinave, i cili është një nga hallkat kryesore të zhvillimit të ekonomisë qarkore.

Nga të dhënat e raportuara nga komunat dhe operatorët për menaxhimin e mbeturinave për vitet 2023 dhe 2024 AMMK ka vlerësuar se nuk janë bërë hapa konkret për ndarjen e mbeturinave në burim pasi viteve të fundit edhe banorët kanë hasur në vështirësi për mbledhjen e rregullt të mbeturinave komunale nga kompanitë e kontraktuara.

Për të realizuar një sistem të qëndrueshëm të ndarjes së mbeturinave në burim dhe mbledhjes kërkohet një planifikim i detajuar, duke përfshirë këtu në radhë të parë ndryshime infrastrukturore, ndërtimin e sistemit të trajtimit të mbeturinave dhe sidomos bashkërendimin me sektorin e riciklimit, senzibilizimin e qytetarëve etj.

Në Kosovë ka disa operatorë që merren me riciklimin e një sasive të mbeturinave, se sa është niveli i riciklimit nuk ka të dhëna të raportura, mirëpo AMMK ka bërë një vlerësim se diku rreth 3% e mbeturinave që gjenerohen në Kosovë brenda vitit riciklohen nga këta operator.

Edhe pse aktiviteti i këtyre operatorëve është më i madh, ata kryesisht përmes sektorit joformal bëjnë mbledhjen dhe përgatitjen e mbeturinave të riciklueshme për ti eksportuar jashtë vendit. Andaj, në mungesë të të dhënave nga raportimi, ju kemi referuar të dhënave nga anketimet e ASK-së lidhur me sasinë e mbeturinave të trajturara për vitin 2023 dhe ato janë paraqitur në (tabelën 8) në vijim:

⁴ European Environment Agency, *Waste and recycling*, 2025

Tabela 8. Mbeturinat e trajtuara (ton) sipas llojit për vitin 2023, (ASK)⁵

Mbeturinat	Deponuar	Ricikluar	Sterilizuar	Gjithsej
Mbeturinat spitalore	/	/	2,540	2,540
Mbeturinat e letrës dhe kartonit	/	16,869	/	16,869
Mbeturinat nga metalet	/	4,646	/	4,646
Mbeturinat nga plastika	/	4,221	/	4,221
Mbeturinat nga ekonomite familjare dhe të ngjashme	490,316	/	/	490,316
Gjithsej	490,316	25,736	2,540	518,592

Sqarim:⁶Anketimet e ASK-së lidhur me sasinë e mbeturinave të trajturara për vitin 2024 nuk janë publikuar ende dhe në mungesë të tyre kemi paraqitur vetëm të dhënat për vitin 2023 të cilat janë publikuar në raportin Anketa e Mbeturinave të Trajtuara – ASK⁷.

Politikat për zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit nga niveli qendror dhe lokal duhet të fokusohen dhe të krijojnë mekanizma për zhvillimin dhe avancimin e procesit të riciklimit i cili pos që do të minimizojë ngarkesën e deponive me mbeturina, do të ndikojë edhe në përmirësimin e gjendjes në mjedis, dhe poashtu do të ndikojë pozitivisht edhe në aspektin socio-ekonomik.

Megjithatë, arritja e objektivave të BE-së për mbeturinat kërkon përpjekje të konsiderueshme. Produktet e pariciklueshme duhet të hiqen gradualisht nga përdorimet tona të përditshme dhe mbeturinat duhet të mblidhen veçmas në mënyrë që të mund të riciklohen.

Veprimet në lidhje me mbeturinat dhe ekonominë rrethore kontribuojnë në uljen e nevojës për materiale të reja parësore dhe emetimet e gazrave serrë që lidhen me nxjerrjen dhe përpunimin e burimeve natyrore. Përfshirja e ekonomisë rrethore dhe aktiviteteve të mbeturinave në raportimin mbi politikën dhe masat për zbutjen e ndryshimeve klimatike mund të ndihmojë në dhënien e një pasqyre më të plotë të përpjekjeve të një vendi për zbutjen e tyre. Kjo qasje mund të zbulojë më tej mundësitë e politikave për të zhbllokuar ulje shtesë të emetimeve të gazrave serrë dhe për të ndihmuar vendet të arrijnë objektivat e tyre. Disa forma të politikave dhe masave të ekonomisë rrethore përfshihen në 6% të politikave klimatike të raportuara nga vendet evropiane (me një fokus në mbeturina).⁸ Sektori i mbeturinave përbën rreth 3% të emetimeve totale të gazrave serrë (GHG), përdorimi më i mirë i mbeturinave si burim mund të ndihmojë në uljen e emetimeve të gazrave serrë në sektorë të tjerë.⁹

⁵ ASK, Anketa e Mbeturinave të Trajtuara, 2023

⁶ Anketimet e ASK-së lidhur me sasinë e mbeturinave të trajturara për vitin 2024 nuk janë publikuar,

⁷ ASK, Anketa e Mbeturinave të Trajtuara, 2023

⁸ European Environment Agency, Waste and recycling, 2025

⁹ European Environment Agency, Waste and recycling, 2025

3.8. Mbeturinat Spitalore

Mbetjet spitalore trajtohen përmes një procesi sterilizimi në shtatë sterilizatorë të instaluar në shtatë spitale rajonale. Kryesisht, përmes sterilizimit trajtohen shiringat, infuzionet dhe pajisje të ndryshme të përdorura gjatë trajtimeve shëndetësore. Pas trajtimit me sterilizim dhe imtësimit, këto mbetje vendosen në kontejnerë për mbetje të ngurta urbane dhe më pas deponohen në deponi.

Mbetjet spitalore dhe mjekësore kategorizohen në disa grupe dhe trajtohen në mënyra të specializuara për të siguruar menaxhimin e duhur dhe mbrojtjen mjedisore.

Një pjesë e mbeturinave spitalore, kryesisht barnat me afat të skaduar, suplemente të ndryshme etj., asgjësohen në furra për shkrirjen e metaleve në kompani të certifikuara me leje mjedisore. Një tjetër grup i mbeturinave përbëhet nga mbeturinat patologjike, si placenta, embrione, amputime, lëngje trupore etj., të cilat qendrat spitalore, përmes kompanive të kontraktuara, i groposin në varreza dhe i dezinfektojnë me gëlqere.

Mbeturinat kimike, të përdorura në kujdesin shëndetësor, nuk ndahen dhe nuk trajtohen në mënyrë të veçantë sipas legjislacionit, dhe supozohet se hidhen apo menaxhohen në mënyrë jo të duhur. Sa i përket mbeturinave farmaceutike, përfshirë medikamentet citostatike, këto deponohen në sasi të konsiderueshme në depo qendrore në Prishtinë, ndërsa një pjesë ruhet edhe në spitalet rajonale. Tabela 9 paraqet pasqyrën e sasisë së mbeturinave të ricikluara, sterilizuara në impiantet përkatëse, të deponuara dhe gjithsej të trajtuara gjatë vitit 2024. Ky proces nënvizon rëndësinë e përmirësimit të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave spitalore dhe mjekësore për të minimizuar ndikimet mjedisore dhe shëndetësore.

Tabela 9: Sasia e mbeturinave spitalore të sterilizuara në 8 qendrat spitalore rajonale

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
	kg	kg	kg	kg	kg	kg	kg
Prishtinë	360,819.10	487,169.60	766,347.40	465,335.00	610,564.20	756,882.00	838,359.00
Prizeren	100,175.70	97,195.20	96,227.50	96,290.80	106,782.70	74,262.00	57,010.7
Pejë	49,215.00	45,720.00	50,480.00	47,560.00	44,678.00	44,488.00	59,317.0
Ferizaj	35,465.90	39,215.00	37,664.40	39,934.30	38,914.80	30,014.50	34,818.00
Gjilan	26,460.40	29,859.80	40,748.00	42,046.00	39,689.00	47,687.00	42,425.00
Gjakovë ¹⁰	2,951.00	3,357.00	3,159.00	3,284.00	1,288.00	0.00 ¹¹	689.0
Mitrovicë	72,323.00	85,149.00	68,214.00	67,174.00	76,250.00	73,798.00	77,320.3
Vushtrri	2,504.00	2,580.35	632.61	1,185.74	2,613.55	2,541.21	1,622.36
Totali	649,914	790,245	1,063,472	762,809	920,780	1,029,672	1,111,561

¹⁰ Në kuadër të menaxhimit të mbeturinave, në Gjakovë janë trajtuar gjithsej 1,658 kg mbeturina nga to në spitalet e Pejës dhe Ferizajit janë trajtuar 969 kg mbeturina.

Mbetjet spitalore të trajtuara nga këto qendra tregojnë një rritje të sasisë së përpunuar prej 81,889 kg në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023, duke reflektuar një përmirësim të përgjithshëm të performancës së impianteve. Në nivel kombëtar, vërehet një **rritje** prej 8% në sasinë totale të përpunuar/ trajtuar midis viteve 2023 dhe 2024.

Gjatë vitit 2024, vërehet se rritja e përgjithshme e sasisë së mbeturinave të përpunuara është kryesisht e përqendruar në impiantin e QKUK-Prishtinë. Ky impiant ka trajtuar sasinë më të madhe në nivel vendi, me një total prej 838,359 kg.

Më pas, impianti në spitalin e Mitrovicës ka trajtuar 77,320.3 kg, ndërsa sasia më e vogël prej 689 kg është përpunuar në impiantin në Gjakovë (tabela 9). Këto të dhëna tregojnë koncentrimin e aktivitetit më të madh në qendrat kryesore spitalore dhe nevojën për monitorim të vazhdueshëm për të optimizuar menaxhimin e mbeturinave në të gjitha impiantet.




Figura 10. Trendi dhe sasia e mbeturinave spitalore të sterilizuara në 8 qendrat spitalore rajonale

3.9. Importi dhe eksporti i thasëve dhe qeseve të plastikës si dhe i mbetjeve

Ndotja nga plastika përbën një ndër sfidat më serioze mjedisore si në nivel global, ashtu edhe në atë lokal. Ajo paraqet një kërcënim të drejtpërdrejtë për ekosistemet natyrore, biodiversitetin, shëndetin e njeriut dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Në vendin tonë, ky problem është bërë gjithnjë e më i dukshëm, veçanërisht përmes përhapjes së pakontrolluar të mbetjeve plastike të prodhuara dhe të përdorura çdo ditë, kryesisht ato nga produktet njëpërdorimshme, si qeset plastike.

Mbetjet plastike hasen gjithandej nëpër rrugë, trotuare, lumenj, në fushat bujqësore, pyje, liqene dhe hapësira të tjera publike apo natyrore duke treguar për shkallën alarmante të përhapjes së tyre. Faktorë themelor të kësaj sitate janë mungesa e menaxhimit të duhur të mbeturinave, niveli ende i ulët i vetëdijes qytetare, si dhe mospërfshirja e alternativave të qëndrueshme, duke përkeqësuar këtë situatë dhe e kthyer ndotjen plastike në një kërcënim të përhershëm për mjedisin dhe shëndetin publik.

Qeset plastike, ndonëse përdoren për një kohë shumë të shkurtër, kanë një jetëgjatësi mjedisore shumë të gjatë, që mund të arrijë deri në qindra vjet. Për shkak të përbërjes së tyre jo të biodegradueshme, ato qëndrojnë në natyrë për dekada, duke kontribuar në ndotjen afatgjatë të tokës, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësorë, si dhe në dëmtimin e faunës dhe florës.

Në Kosovë, një nga burimet kryesore të ndotjes plastike është importi dhe përdorimi i gjerë e i vazhdueshëm i qeseve plastike, të cilat shpërndahen në masë të madhe në qendrat tregtare, dyqanet ushqimore dhe aktivitetet të ndryshme ekonomike. Shumica e tyre nuk riciklohen apo ripërdoren, dhe përfundimi më i zakonshëm është në deponi të hapura, në natyrë apo në brigjet e lumenjve. Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e mbeturinave komunale të gjeneruara nga amvisëritë dhe bizneset përbëhet nga qese dhe thasë plastike. Për shkak të natyrës së tyre jo të biodegradueshme, këto mbetje kontribuojnë ndjeshëm në ndotjen afatgjatë të mjedisit. Kjo tregon për një problem sistematik në mënyrën se si prodhojmë, konsumojmë dhe menaxhojmë materialet plastike në përditshmërinë tonë.

Bazuar në të dhënat zyrtare nga Dogana e Kosovës, trendi i importit dhe eksportit të thasëve dhe qeseve plastike ka pasur ndryshime të dukshme nga viti 2018 deri në 2024.

Në vitin 2021 u shënuar vlera më e lartë e importit me mbi 10 milion kg, një rritje shumë më madhe krahasuar me vitet e mëparshme dhe pasuese. Mirpo pas këtij viti, importi ka pësuar një rënie të madhe, duke u ulur në rreth 959 mijë kg në vitin 2022, si dhe më tej në 820 mijë në vitin 2023. Ky trend pasqyron përpjekje të vazhdueshme për uljen e përdorimit të plastikës njëpërdorimshme, me një përjashtim të pazakontë në vitin 2021, dhe sugjeron një orientim drejt politikave më të qëndrueshme mjedisore në vitet e fundit (Figura 11).

Po ashtu, vlenë të theksohet se gjatë vitit 2024 janë importuar 258,936 kg thasë dhe qese plastike, duke shënuar një rënie prej 68.4% krahasuar me vitin 2023 kur ishin importuar 820,099 kg.




Figura 11. Sasia e thasëve dhe qeseve plastike të importuara 2018 – 2024

Gjatë periudhës 2018–2024, eksporti i thasëve dhe qeseve plastike nga Kosova ka shënuar një rritje të vazhdueshme dhe të konsiderueshme. Ky trend pasqyron zhvillimin e qëndrueshëm të kapaciteteve prodhuese vendore si dhe fuqizimin e pranisë së produkteve kosovare në tregjet ndërkombëtare. Rënia e lehtë e eksportit në vitin 2024 mund të interpretohet si një fazë stabilizimi pas një rritjeje të shpejtë gjatë viteve të mëparshme (figura 12).

Në anën tjetër gjatë vitit 2024 janë eksportuar 3,091,778 kg thasë dhe qese plastike, duke shënuar një rënie prej 3.4% krahasuar me vitin 2023, kur kjo sasi ishte 3,200,686 kg.




Figura 12. Sasia e thasëve dhe qeseve plastikë të eksportuara 2018 – 2024

Të dhënat tregojnë një ulje të ndjeshme të importit dhe një rënie të lehtë të eksportit të qeseve dhe thasëve plastike në vitin 2024, krahasuar me një vit më parë.

Kjo rënie si në import ashtu edhe në eksport mund të jetë pasojë e ndikimit pozitiv që ka pasur zbatimi i Udhëzimit Administrativ (QRK) nr. 04/2025 për Ambalazhin dhe Mbeturinat e Ambalazhit. Ky udhëzim ka shërbyer si bazë për vendimin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të datës 5 tetor 2023, për vendosjen e tarifës prej 5 centësh për çdo qese plastike të përdorur.

Raportimi nga Prodhimi i Qeseve Plastike nga Prodhuesit Vendorë

Sipas Udhëzimit Administrativ për qeset plastike, Neni 42, Pika 1, prodhuesit e qeseve plastike janë të obliguar të raportojnë në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) numrin e qeseve të prodhuara gjatë vitit paraprak.

Ky raportim është në përputhje me kërkesat ligjore dhe administrative që synojnë mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të përdorimit të plastikës në Kosovë. Për më tepër, këto masa kontribuojnë në zbatimin e politikave për reduktimin e përdorimit të qeseve plastike dhe promovimin e alternativave më ekologjike, në përputhje me praktikat e vendeve të Bashkimit Evropian.

**Tabela 10.** Prodhimi i qeseve plastike nga disa kompani vendore 2024

<i>Prodhimi i qeseve plastike nga kompanit vendore</i>			
Prodhimi 2024	Qese ambalazh/ Qese plastike mbajtëse 25 - 50 mikron	Qese 50 mikron/ Qese plastike mbajtëse mbi 50 mikron	Sasia/ Copë
Totali	17,206,986.00	55,713,868.20	Copë

Tabela paraqet të dhëna të pjesshme mbi prodhimin e qeseve plastike në Kosovë nga prodhuesit vendor për vitin 2024. Raportimi nuk përfshin të gjitha të dhënat nga kompanitë që merren me këtë aktivitet prodhues në Kosovë, për shkak të mos-raportimit dhe vështirësive në mbledhjen e të dhënave.

Në total, të dhënat e raportuara nga prodhuesit vendor tregojnë se prodhimi i qeseve plastike për të dy kategoritë e madhësive (25-50 mikron dhe mbi 50 mikron) për vitin 2024 arrin në rreth 17.2 milionë copë për qeset më të vogla dhe mbi 55.7 milionë copë për qeset më të mëdha, duke dëshmuar një volum të konsiderueshëm të prodhimit vendor (shiko tabelën 10).

3.10 Pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe planifikuese për MM

Bazuar në legjislacionin në fuqi që rregullon fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe veçmas MK, janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e komunave për menaxhim të mbeturinave brenda territorit të tyre. Nga kjo bazë ligjore derivojnë edhe dokumentet planifikuese në nivelin qendror dhe lokal të cilat ofrojnë një kornizë zhvillimi të sektorit të mbeturinave.

Andaj, me zbatimin e detyrave dhe obligimeve ligjore, si dhe me realizimin e objektivave të dokumenteve planifikuese, komunat e përmirësojnë gjendjen në sektorin e menaxhimit të mbeturinave.

Në kuadër të treguesit: ***Pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe planifikuese për menaxhim të Mbeturinave, gjatë viteve 2023 dhe 2024*** nga komunat që kanë raportuar janë përfshirë disa elemente kyçe që përbëjnë këtë indikator.

1. Hartimi dhe miratimi i PKMM;
2. Hartimi dhe miratimi i Rregullores komunale për menaxhim të mbeturinave;
3. Punësimi i përhershëm i zyrtarit për menaxhim të mbeturinave, përshkrimi i punës i të cilit siguron që të paktën 50% e përgjegjësive janë për menaxhim të mbeturinave;
4. Punësimi i inspektorit mjedisor, përshkrimi i punës i të cilit siguron përgjegjësi në fushën e menaxhimit të mbeturinave;
5. Kontraktimi i operatoreve të licensuar për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave komunale;
6. Kontraktimi i operatorëve të licensuar për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, duke zbatuar procedurat e prokurimit;
7. Caktimi i tarifave të shërbimit duke kaluar procesin tarifor për mbledhjen, transportin dhe deponimin e mbeturinave komunale, përmes kalkulimit të kostove të shërbimit, profilizimin e klientëve dhe caktimin e tarifave të shërbimit;
8. Caktimi i qendrës për grumbullim, trajtim dhe deponim të mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore;
9. Shqiptimin e gjobave mandatore.

Komunat kanë përgjegjësi të përmbushjes së obligimit ligjor për raportim brenda afatit të përcaktuar deri më 31 mars të vitit vijues për vitin raportues paraprak. Pas shqyrtimit të të dhënave të raportuara për këtë indikator, vlerësimit dhe verifikimit të tyre me dokumente mbështetëse është nxjerrë një pasqyrë e përgjithshme e realizimit të proceseve në pajtueshmëri me kornizën ligjore dhe planifikuese për menaxhim të mbeturinave.

Gjatë viteve 2023 dhe 2024, në Kosovë është vërejtur një nivel i ndryshëm përmbushjeje të proceseve ligjore në rajone të ndryshme lidhur me menaxhimin e mbeturinave, mirëpo ajo që vërehet është se asnjë komunë nuk ka arritur nivelin 100 % të përmbushjes së proceseve ligjore.

Rajoni i Gjilanit ka shënuar nivelin më të ultë të përmbushjes së proceseve ligjore me 44% në vitin 2023, ndërsa po ashtu edhe në vitin 2024 vërehet një rënie në 41%.

Rajoni i Ferizajt ka shënuar nivelin më të lartë të përmbushjes së proceseve ligjore me 81% në vitin 2023 dhe në vitin 2024.



Në nivel vendi, gjatë viteve 2023-2024, niveli i realizimit të proceseve-kërkesave ligjore për menaxhimin e mbeturinave ka arritur një mesatare prej rreth 65 -66 % të zbatueshmërisë.

Kjo tregon se komunat duhet të tregojnë një përkushtim të vazhdueshëm për të përmbushur kërkesat ligjore në këtë sektor.

Tabela 11. Pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe planifikuese për menaxhim të MK, (2023 & 2024)

RAJONI	Viti	1.PKMM	2.RRKMM	3.Zyrtari MM	4.Inspektori m jedisor	5.Kont. op. licenc/ MK	6.Kont. op. licenc/ MND ¹²	7.Procesit tarifar	8.Qendra për MND	9. Gjoha mandatore	Mesatarja e proceseve të zbatuara
PRISHTINËS	2023	100%	100%	86%	86%	71%	0%	86%	71%	57%	73%
	2024	86%	86%	71%	71%	71%	0%	86%	57%	86%	68%
MITROVICËS	2023	75%	75%	75%	75%	75%	0%	75%	75%	75%	67%
	2024	75%	75%	75%	50%	75%	0%	75%	75%	75%	64%
PEJËS	2023	100%	100%	100%	100%	100%	0%	33%	33%	33%	67%
	2024	100%	100%	100%	100%	33%	0%	100%	67%	100%	78%
PRIZRENIT	2023	83%	100%	67%	83%	100%	0%	67%	83%	83%	74%
	2024	83%	100%	83%	83%	83%	0%	83%	83%	67%	74%
FERIZAJT	2023	100%	100%	100%	100%	75%	0%	100%	50%	100%	81%
	2024	100%	100%	100%	100%	75%	0%	100%	75%	75%	81%
GJILANIT	2023	57%	43%	57%	57%	57%	0%	43%	43%	43%	44%
	2024	71%	29%	43%	71%	57%	0%	43%	29%	29%	41%
GJAKOVËS	2023	100%	100%	100%	100%	100%	0%	100%	67%	33%	78%
	2024	100%	100%	67%	100%	100%	0%	100%	100%	67%	78%
Komunat që kanë zbatuar procesin	2023	30	30	27	28	27	0	24	21	21	23
	2024	30	28	25	27	24	0	27	21	23	23
Mesatarja e realizimit të procesit/eve	2023	85.7%	85.7%	77.1%	80.0%	77.1%	0%	68.6%	60.0%	60.0%	66%
	2024	85.7%	80.0%	71.4%	77.1%	68.5%	0%	77.1%	60.0%	65.7%	65%

Sikurse në vitet paraprake edhe për vitet 2023-2024 procesi i cili nuk është realizuar nga komunat është procesi nr. 6, dhe kjo tashmë dihet se është duke ndodhur për shkak të mos kontraktimit të kompanive të licencuara për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi. Kjo dukuri është e ndërlidhur në mungesë të kompanive të licencuara për menaxhimin me

¹² Deri më tani, nuk ka kompani të licencuar, prandaj kontraktimi i operatorëve të autorizuar për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore është zero.

mbeturina të ndërtimit dhe rrënimit. Megjithatë është vlerësuar se disa komuna kanë ndërmarrë hapa për menaxhimin e këtyre mbeturinave duke kontraktuar kompanitë publike që operojnë në territorin e komunave, kompani private ndërtimore apo ndonjë formë tjetër.

Gjatë viteve 2023 - 2024, proceset më të avancuara në zbatim nga komunat kanë qenë: Procesi 1: Hartimi dhe miratimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (PKMM), dhe procesi 2: Hartimi dhe miratimi i Rregullores Rajonale për Menaxhimin e Mbeturinave (RrKMM).

Procesi që është realizuar më pak gjatë viteve 2023 dhe 2024 është: Procesi 8: Caktimi i qendrës për grumbullim, trajtim dhe deponim të mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, i cili është realizuar vetëm nga 21 komuna që kanë raportuar.

Kjo tregon se ndonëse komunat kanë bërë përpjekje në shumicën e proceseve të menaxhimit të mbeturinave, ende ka sfida të konsiderueshme në **fushën e trajtimit të mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi, që kërkon vëmendje të veçantë dhe përmirësim të vazhdueshëm për të arritur nivelin e realizimit 100%.**




Figura 13. Niveli në (%) i plotësimit të proceseve të kërkuara në nivel vendi, (2023 & 2024)

Të dhënat e detajuara lidhur me shkallën e realizimit të proceseve janë dhënë në shtojcën 6 - 7 në raport.

3.11 Menaxhimi i mbeturinave dhe ekonomia rrethore (qarkore)¹³

Menaxhimi i mbeturinave dhe ekonomia rrethore kanë potencial të madh për të kontribuar në zbutjen e ndryshimeve klimatike, dhe për këtë arsye Kosova mund të përfitojë nga integrimi i Planeve të Menaxhimit të Klimës (PMM) në këto fusha si pjesë të politikave klimatike kombëtare.

Në këtë përmbledhje, kemi shqyrtuar më tej këtë dimension duke analizuar se si vendet evropiane përfshijnë ekonominë rrethore dhe menaxhimin e mbeturinave në raportimin e tyre mbi politikat dhe masat për zbutjen e ndryshimeve klimatike, si dhe sesi masat shitesë mund të ndihmojnë në përsheptimin e reduktimeve të ardhshme të emetimeve të gazrave serrë.

Integrimi në familjen evropiane për Kosovën lidhet ngushtë me rolin kyç që ekonomia rrethore dhe menaxhimi i mbetjeve mund të kenë në arritjen e objektivave klimatike. Kuptimi dhe vlerësimi i këtij potenciali lejon një raportim më të plotë dhe integrimin e aktiviteteve ekzistuese për reduktimin e emetimeve, pavarësisht nëse këto tashmë raportohen apo jo. Kjo qasje integruuese është kyçe që Kosova të shfrytëzojë në mënyrë efektive ekonominë rrethore në luftën kundër ndryshimeve klimatike, duke përfshirë menaxhimin e mbeturinave si një shtyllë e rëndësishme për reduktimin e emetimeve dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë mjedisore.

Nxjerrja dhe përpunimi i materialeve si lëndët djegëse fosile, biomasa, metale dhe minerale jometalike përbëjnë afërsisht 50% të emetimeve globale të gazrave serrë. Qëllimi kryesor i ekonomisë rrethore është të ruajë vlerën e produkteve dhe materialeve gjatë përdorimit të tyre për sa më gjatë, duke ulur kështu kërkesën për resurse natyrore dhe emetimet që lidhen me nxjerrjen dhe përpunimin e tyre.

Për shembull, riciklimi i mbeturinave të qelqit dhe përdorimi i tyre si lëndë e parë sekondare në prodhimin e qelqit të ri kërkon më pak energji sesa përdorimi i materialeve të reja, duke ulur kështu emetimet. Ky është një shembull konkret i veprimeve të ekonomisë rrethore në sektorin e prodhimit të qelqit.

Kthimi i mbetjeve në ekonomi përmes riciklimit është thelbësor për zbatimin e ekonomisë rrethore. Emetimet e gazrave serrë në sektorin e mbeturinave kryesisht gjenerohen nga trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme. Mbetjet e ngurta mund të riciklohen, depozitohen në deponi, digjen ose trajtohen biologjikisht. Metani nga deponitë e mbeturinave përbën rreth 70% të emetimeve të sektorit të mbeturinave. Në vendet evropiane, parashikohet që këto emetime të ulen ndjeshëm, deri në 58% deri në vitin 2035 krahasuar me nivelet e vitit 1990.

Vendet evropiane janë angazhuar për të miratuar dhe zbatuar politika dhe masa efektive për uljen e emetimeve në të gjitha sektorët, duke përfshirë edhe sektorin e mbeturinave.

Në këtë kontekst, Kosova duhet të zhvillojë politika të integruara për mbledhjen efikase dhe përpunimin e mbeturinave në materiale të riciklueshme. Kjo jo vetëm ndihmon në menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave, por edhe redukton nevojën për materiale të reja, të cilat kërkojnë më shumë energji gjatë prodhimit, duke sjellë përfitime mjedisore dhe ekonomike.

¹³ European Environment Agency, *Capturing the climate change mitigation benefits of circular economy and waste sector policies and measures*, 2024



Suksesi në këtë fushë kërkon bashkëpunim ndërsektorial, përfshirë institucionet shtetërore, komunat, bizneset, organizatat joqeveritare dhe komunitetin. Bashkëpunimi duhet të sigurojë koordinim në politikën e menaxhimit të mbeturinave, infrastrukturë, investime dhe edukim publik.

Gjithashtu, tregjet për blerjen dhe përdorimin e materialeve të ricikluara në industrinë prodhuese kërkojnë zhvillim dhe përmirësim. Kjo përfshin investime në teknologji dhe kapacitete, si dhe krijimin e kushteve të favorshme për bizneset që përdorin materiale të ricikluara.

Vetëm përmes këtij angazhimi të përbashkët dhe përmirësimeve të vazhdueshme në tregjet e materialeve, Kosova mund të ndërtojë një sistem efektiv dhe ekonomikisht të qëndrueshëm për riciklimin.



GJETJET E RAPORTIT

- Grumbullimi total i mbeturinave ka rënë nga 471,278.00 ton në vitin 2023 në 449,707.93 ton në 2024 (ulje prej 21,570,07 ton).
- Gjenerimi i mbeturinave për banor është rritur ndjeshëm në shumicën e komunave nga 240.15 kg/banor/vit në 293.60 kg/banor/vit, – kjo tregon se numri i banorëve të rinj (nga regjistrimi i fundit në vitin 2024) është më i ulët se vlerësimi i mëparshëm.
- Në pothuajse të gjitha komunat është shënuar përmirësim i madh në eliminimin e deponive të egra, vërehet një rritje e numrit të deponive të vogla, ndërsa deponitë e mëdha dhe të mesme janë zvogëluar në nivelin rajonal të vendit.
- Në shkallën e mbulimit, me shërbim të mbledhjes së mbeturinave për ekonomitë familjare në nivel të vendit të dhënat tregojnë tregojnë një ndryshim të vogël negativ një ulje prej rreth 2.7% krahasuar me vitin paraprak.
- Treguesit financiarë të faturimit dhe arkëtimit për shërbimet e ekonomive familjare në rajone tregojnë ndryshime të dukshme në krahasim me vitin 2023. Në nivel vendi, faturimi është rritur nga rreth 19 milionë euro në 20.2 milionë euro, ndërsa arkëtimi ka përmirësuar normën nga 16.9 në 18.2 milionë euro.
- Trendi i rritjes së shkallës së arkëtimit për ekonomitë familjare ka shënuar një përmirësim për vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 në disa rajone kryesore.
- Niveli i përmbushjes së pajtueshmërisë ligjore për menaxhimin e mbeturinave ka arritur një mesatare prej 65 - 66% të zbatueshmërisë, duke mbetur i njëjtë krahasuar me vitin paraprak.
- Për dallim nga viti 2023, kur sasia totale e mbeturinave të depozituara në deponitë sanitare ishte 493,116.48 tonë, në vitin 2024 kjo sasi është ulur në 468,111.50 tonë, vërehet një ulje afërsisht 4.9%.

REKOMANDIME

- Komunat, operatorët e menaxhimit të mbeturinave dhe institucionet qendrore, duhet të zhvillojnë politika që nxisin parandalimin e gjenerimit të mbeturinave dhe të investojnë në trajtimin-riciklimin e mbeturinave;
